

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) me qëllim ofrimin e një ambienti për ofrimin e shërbimeve të pijeve të ngrohta, pijeve të ftohta, snack dhe artikuj ushqimor për shkak të numrit të punonjësve, fluksit të punës, manaxhimin e ambienteve dhe të ardhurave të institucionit dhe në veçanti respektimin e rregullave të higjenës, fton subjektet të cilat kanë si objekt servisin e pajisjeve elektronike dhe automatike, nën vullnetin e tyre të lirë, të dorëzojnë kërkesat e tyre, shprehje interesi për marrje me qira të një ambienti brenda DPSHTRR-së me një sipërfaqe prej 3 m² për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore.

Theksojmë se qëllimi i këtij bashkëpunimi konsiston në:

- Ofrimin e shërbimit të vendosjes së makinetave automatike për punonjësit e DPSHTRR;
- Respektimin maksimal sipas të gjitha rregullave higjieno - sanitare gjatë ofrimit të shërbimit si dhe konsumimit të tij;
- Mirëmbajtjen e pajisjeve të makinetave.

Persona/subjektet janë të lutur të shprehin interesin nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit të mëposhtëm:

1. Kërkesë e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, sipas planit të biznesit.
2. Formulari i cmimit të ofertës financiare duke përcaktuar vlerën qirasë të përlllogaritur pa TVSH dhe me TVSH, për muaj/vjetore për m² me afat një vjeçar.
3. Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - *Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;*
 - *Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;*
 - *Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara*
4. Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
 - *Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues; Në rast se personi/subjekti është organizatë jofitimprurëse duhet të deklaroj se është regjistruar si person juridik sipas ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001” Për organizatat jo Fitimprurëse”.*
 - *Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;*
 - *Deklaratë për administratorin, ortakët, dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin; Për shtetasit/subjektet e huaja duhet të dorëzohet deklaratë e përfaqësuesit ligjor mbi gjëndjen gjyqësore civile dhe penale.*
 - *Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;*

- *Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim.*
- 5. Liçence, Kodi II.a.A (1) lëshuar nga QKB.
- 6. Leje mjedisore konform parashikimeve ligjore ne fuqi.
- 7. Akt miratimi higjeno –sanitar lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor.
- 8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 22000:2018. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

Afati kohor për dorëzimin e kërkesës dhe dokumentacionit do të jetë nga data 18.07.2025 dhe do të ketë afat deri më datë 25.07.2025, për paraqitjen pranë institucionit të DPSHTRR-së të kërkesave dhe dokumentacionit.

Kërkesa për shprehje interesi dhe dokumentacioni duhet të dorëzohet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor me adresë: Blv “Gjergj Fishta”, Pall.Bjorn, Tiranë ose në adresën e e-mailit: dpshtrr@dpshtrr.gov.al.